

20150150280

LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURI DHE SHËNDET GJATË PUNËS

Neni 1

Në Ligjin për siguri dhe shëndet gjatë punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 92/2007, 136/11, 23/13, 25/13, 137/13, 164/13 dhe 158/14) në nenin 22 pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijoni:

"(6) Për të punësuarit që kanë qasje dhe manipulojnë me armë zyrtare të zjarrit, krahas minimumit standard të kontrollit sistematik nga paragrafi (5) i këtij neni, i njëjti përmban edhe kontroll psikiatrik dhe psikologjik, ndërsa detyrimisht përfundon me konstatim nëse personi është i aftë që t'i kryejë punët në vendin e punës për mbajtje, qasje dhe përdorim të armës zyrtare të zjarrit."

Paragrafi (6) bëhet paragraf (7)

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".